



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 252/6 prot.

Tiranë, më 13.6.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 651, datë 27.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Urim Buci
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dajeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.5.2023, është njoftuar vendimi nr. 651, datë 27.4.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Urim Buci, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër.

Ndaj këtij vendimi, bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”, të aneksit të Kushtetutës, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 30.5.2023, është depozituar akti “Rekomandim për paraqitje ankimi”, nënshkruar nga një komision prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, datë 30.5.2023, ushtron ankim ndaj vendimit nr. 651, datë 27.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Urim Buci, ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër, dhe në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit z. Urim Buci, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Prokuroria e Përgjithshme, nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Urim Buci*”² ka referuar se:

- i Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive;*
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë **.10.2017, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Urim Buci*”, raport i deklasifikuar plotësisht, pas kërkesës së Komisionit për përditësim dhe deklasifikim informacioni.

2.3 Prokuroria e Përgjithshme, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin³ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, z. Urim Buci.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e gjendjes pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurore krahasuar me atë “Vetting”, kryesisht lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë: godinë e kombinuar banimi 3 kate, të ardhurat nga emigracioni, shpenzimet, pagimin e detyrimeve financiare, si dhe çdo të dhënë tjetër të

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Shkresa e ILDKPKI-së me nr. ***/** prot., datë **.11.2019.

³ Raport i Prokurorisë së Përgjithshme nr. ***/** prot., datë **.9.2018.

dalë nga hetimi administrativ lidhur me këtë kriter, për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, në përfundim të vlerësimit tërësor të çështjes, ndër të tjera, ka vlerësuar se: [...] *Mungesa e burimit të ligjshëm për krijimin e një pasurie para detyre si e vetmja gjetje në kuadër të vlerësimit të pasurisë së subjektit, nuk është në atë shkallë sa të përbëjë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cenuar besimin e publikut te drejtësia. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

3.2 Për kontrollin e figurës. Referuar nenit Dh të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, edhe pas hetimit administrativ, ka arritur në përfundimin se: [...] *subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016. [...].*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, i ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar dhe vlerësuar raportin e përgatitur nga Prokuroria e Përgjithshme, denoncimet e publikut, gjetje të tjera lidhur me këtë kriter, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit në dy procedime, atë me nr. ***/2021 dhe nr. ***/2022, duket se ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Ndërsa në rastin e procedimit nr. ***/2019, administruar si denoncim nga *** Bank, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka shfaqur mangësi. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se këto tri çështje duhen transferuar pranë organit kompetent, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, bazuar në nenin 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016. Duke transferuar për inspektim këto tri çështje, Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit arrin një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, dhe nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, me shumicë votash⁴, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Urim Buci, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër.

II. Rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)

5. Bazuar në nenin B, pika 3, germa “c”⁵ e aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2⁶ e ligjit nr. 84/2016, një komision i përbërë nga tre përfaqësues të ONM-së, më datë 30.5.2023, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, protokolluar me nr. 252/2 prot., aktin: “*Rekomandim për paraqitje ankimi*” ndaj vendimit nr. 651, datë 27.4.2023, të

⁴ Anëtarja e trupit gjykues, znj. ***.***, ka dalë me mendim në pakicë për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

⁵ Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra ... u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim, duke dhënë arsyet e refuzimit.

⁶ Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të ONM-së.

Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Urim Buci (bashkëlidhur këtij ankimi).

6. Objekti i këtij rekomandimi, në mënyrë të përmbledhur, lidhet me rezultatet e dala nga hetimi administrativ për kriterin e pasurisë e jo vetëm, posaçërisht në vlerësimin dhe arsyetimin që ka çuar Komisionin në vendimmarrjen për konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit. Sipas rekomandimit, përfundimi në rastin konkret duhet të ishte i ndryshëm, pasi është konstatuar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë së të ardhurave të ligjshme në shumën 7.514.635 lekë, për krijimin e pasurisë *godinë e kombinuar banimi 3 kate*, përfshirë këtu të ardhurat e deklaruara nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar. Në përfundim, ONM-ja rekomandon ankimin e vendimit të Komisionit, lidhur me gjithë rezultatet e dala nga vlerësimi i kriterit të pasurisë, duke përfshirë të gjitha çështjet e tjera të nevojshme.

III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

10. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 651, datë 27.4.2023, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron si çështje për gjykim, rrethana dhe fakte ligjore, për të cilat vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën lidhur me rezultatet e hetimit administrativ mbi kontrollin e kriterit të pasurisë, vlerësimit të aftësive profesionale dhe rastet e konstatuara të gjendjes së konfliktit të interesit, duke i bërë kështu pjesë të shkaqeve të këtij ankimi, për sa parashtrohet edhe në aktin rekomandim, paraqitur nga ONM-ja.

11. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 651, datë 27.4.2023, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret e rivlerësimit.

IV. Analiza e shkaqeve të ankimit

IV.A Kontrolli i pasurisë

12. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

13. Po ashtu, Komisioneri Publik i referohet në këtë aspekt dhe interpretimit gjyqësor, që gjen pasqyrim në jurisprudencën e Kolegjit, si gjykata e procesit, që shqyrton çështjet e juridiksionit të rivlerësimit dhe vendos standardet përkatëse, bazuar në parimet e përgjithshme të një procesi të rregullt ligjor.

14. Rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Urim Buci, ushtron detyrën e prokurorit prej vitit 2015, duke dorëzuar deklaratën e interesave privatë për herë të parë në vitin 2005, në cilësinë e Oficerit të Policisë Gjyqësore, e më pas, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratat e interesave privatë periodikë për vitet 2015 - 2016, dhe në datën **.1.2017, ka dorëzuar Deklaratën “Vetting”, sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, pasuritë për të cilat paraqesim shkaqe ankimi, nisur nga orgjina, zhvillimi dhe burimi i deklaruar, trajtuar së bashku në këtë ankim, janë:

15. Tokë arë (dy parcela) dhe godinë e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo

15.1 Në D-Vett., subjekti ka deklaruar: (i) Tokë “arë”, me sipërfaqe 724 m², nr. pas. ***, vol. **, f. ***, ZK ***, adresa: Kamëz, Tiranë. Faktikisht, kjo sipërfaqe disponohet nga unë, deklaruesi, dhe vëllai im, ***.***. Secili nga ne zotëron faktikisht 50% të kësaj sipërfaqeje. **Burimi:** Të ardhura këto të siguruara nga emigracioni, përkatësisht unë, deklaruesi, në Angli (2000-2004) dhe vëllai, ***.***, në Greqi (1991 – 2012). Vlera: 200.000 ALL, sipas kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., dt. **.7.2007, me noter ***.***, Tiranë. Pjesa në përqindje: 100%.

(ii) Tokë “arë”, me sip. 276 m², nr. pas. ***, vol. **, f.***, ZK ***, adresa: Kamëz, Tiranë. Faktikisht, kjo sipërfaqe disponohet nga unë, deklaruesi, dhe vëllai im, ***.***. Secili nga ne zotëron faktikisht 50% të kësaj sipërfaqeje. **Burimi:** Të ardhurat janë siguruar nga emigracioni, përkatësisht unë, deklaruesi, në Angli dhe vëllai, në Greqi⁷. Vlera: 200.000 ALL, sipas

⁷ Me deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.1.2017, kanë deklaruar: “Deklaroj në përgjegjësinë time personale dhe ligjore se jam pronar i pasurisë nr. ***, vol. **, f.***, ZK ***, me sip. prej 724 m² që ndodhet në Kamëz, Tiranë, dhe pronar i pas. nr.***, vol. **, f.***, ZK ***, që ndodhet në Kamëz, Tiranë. Deklaroj se pronat e sipërcituara i kam blerë së

kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., dhe nr. *** kol., dt. **.7.2007, me noter ***.***, Tiranë. Pjesa në përqindje: 100%.

(iii) Godinë banimi 3 kat + 1 kat papafingo, një pjesë e objektit është me leje ndërtimi, ndërsa një pjesë është në proces legalizimi. Konkretisht, pjesa me leje ndërtimi është miratuar me vendim të KRRT-së nr. **, dt. **.7.2008, të Bashkisë Kamëz, për sipërfaqe totale ndërtimi 318 m² (3 kate), sipërfaqe gjurmë ndërtimi 89 m² (kati i parë). Aktualisht janë përfunduar 3 kate. Objekti nuk është regjistruar akoma në ZVRPP Tiranë. Pjesa e objektit në proces legalizimi ka sipërfaqe 50 m² secili kat (3 kate) dhe në total të tria katet 150 m². Kati i tretë i objektit (si pjesa me leje dhe pjesa në proces legalizimi), është në posedim të dhëndrit tim, ***.***, pasi ky shtetas është investitori i katit të tretë. Të gjitha shpenzimet për ndërtimin dhe mobilimin e katit të tretë të objektit (pjesa me leje ndërtimi dhe pjesa në proces legalizimi), përveç karabinasë, janë bërë nga shtetasi ***.***, i cili aktualisht banon në katin e tretë të objektit 3-katësh. **Burimi:** Të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga unë, deklaruesi, në shtetin anglez, gjatë viteve 2000-2004. **Vlera: 6.918.105** lekë. Pjesa në përqindje: 100%.

15.2 Në DV-2004, dorëzuar në ILDKPKI datë **.10.2005, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e Oficerit të Policisë Gjyqësore, ka deklaruar vetëm objektin e ndërtuar, konkretisht: *Banesë 2-katëshe me sip 150 m², e ndërtuar vetë në vitin 1995, e pahipotekuar. E kam në bashkëpronësi me vëllain tim. Kjo banesë është ndërtuar me të ardhurat e vëllait gjatë emigracionit. Vlera: 10.000.000 lekë. Pjesa në përqindje: 50%.*

15.3 Në DV-2015, para fillimit të detyrës si prokuror, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë *truall*, me të njëjtat të dhëna si më lart, ndërsa lidhur me godinën e banimit ka deklaruar: *Godinë banimi 3 kat + 1 kat papafingo, një pjesë e objektit është me leje ndërtimi, ndërsa një pjesë është në proces legalizimi. Konkretisht, pjesa me leje ndërtimi është miratuar me vendim të KRRT-së nr. **, dt. **.7.2008, të Bashkisë Kamëz, për sipërfaqe totale ndërtimi 318 m² (3 kate), sipërfaqe gjurmë ndërtimi 89 m² (kati i parë). Objekti nuk është regjistruar akoma në ZVRPP Tiranë. Pjesa e objektit në proces legalizimi ka sipërfaqe 50 m² secili kat (3 kate) dhe në total të tria katet 150 m². Burimi: Të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga unë, deklaruesi, në shtetin anglez, gjatë viteve 2000-2004. Vlera: nuk deklarohet. Pjesa në përqindje: 100%.*

15.4 Lidhur me historikun e zhvillimit të pronës, posedimin, gëzimin dhe burimin e ligjshëm për krijimin e saj, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar si vijon:

15.4.1 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se banon: *“Në objektin shtëpi banimi tre kate, në adresën: Rr. “****”, nr. **, Kamëz, ku dy katet e para të ndërtesës janë në pronësinë time, ndërsa kati i tretë në pronësi të dhëndrit tim, shtetasit ***.***”.*

*bashku me vëllain tim, ***.***, por dokumentacioni i pronave është në emrin tim, pasi në kohën e plotësimit të dokumentacionit, vëllai im ka qenë në emigracion. Deklaroj se të ardhurat për shitje-blerjen e këtyre pronave janë nga kursimet tona nga emigracioni, ku secili prej nesh është faktikisht pronar i 1/2 pjesë të këtyre pasurive. Mbi këto prona, vëllai im ka ndërtuar objektin 2-katësh të vetëdeklaruar për legalizim referuar deklaratës nr. ***, dt. **.1.2015. Unë, ***.***, deklaroj se jam dakord me sa u deklarua më sipër, jam pronar i 1/2 pjesë të pasurive të mësipërme dhe disponoj objektin 2-katësh në proces legalizimi, referuar deklaratës nr. ***, dt. **.1.2015”.*

15.4.2 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: *“Objekti 2-katësh ka filluar të ndërtohet nga vëllai, në 1995-2006, kati i dytë ka qenë karabina deri në 2015. Objekt me sip. 62,55 m². Unë zotëroj 50% të objektit 2-katësh, vlera në momentin e krijimit është 10 milionë lekë të vjetra, i cili është përfshirë në certifikatën e pronësisë në datën **.11.2021 dhe është pjesë e objektit godinë 3-katërshe, ku kati i tretë është ndërtuar nga ***.*** (dhëndri). Objekti 3-katësh ka filluar në vitin 2008 dhe përfunduar në 2010, sipas lejes ndërtimit nr. **, datë **.7.2008, të Bashkisë Kamëz, me sip. 318 m². Sipas situacionit të datës **.9.2016, është deklaruar në vlerën 6.918.105 lekë. Nga kjo vlerë duhet të hiqet vlera e katit të dytë banimi, të paguar nga ***.***. Gjithashtu, kësaj vlere (sipas situacionit) duhet t’i zbritet vlera e katit të parë të banimit (shtesa e re), aktualisht e papërfunduar. Për shkak të mbarimit të lejes së ndërtimit, nuk është ndërtuar papafingo. Pjesa është në proces legalizimi vetëdeklaruar nga (gjysma e objektit 2-katësh ndërtuar nga vëllai ***) i është nënshtruar legalizimit dhe vetëdeklaruar me kërkesën nr. ***, datë **.6.2021, nga unë dhe dhëndri ***.***. Të dy objektet 2 dhe 3-katësh (aktualisht një objekt i vetëm), janë në pronësi përkatësisht të vëllait dhe objekti 3-katësh në pronësinë time dhe dhëndrit”*.

15.4.3 Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, subjekti ka deklaruar: (pyetja 3) *“... unë kam kryer shpenzimet e karabinasë sipas lejes së ndërtimit, ndërsa dhëndri do të kryente disa punime në funksion të dy palëve... rifiniturën me sistem kapot... dhe ... (p. 5) ...në këtë vlerë përfshihen punimet e ndërtimit të katit të dytë të objektit ekzistues 2 kate, përveç kolonave dhe soletës që ishte ndërtuar nga im vëlla, ***.***”*.

15.4.4 Në përgjigje të pyetësorit nr. 7, subjekti ka deklaruar: (p. 3.1) *“... në objektin 3-katësh nuk është kryer asnjë investim pas vitit 2016... ende i papërfunduar edhe aktualisht dhe rifiniturë objekti me sistem kapot, si dhe izolim solete, të kryer nga ***.***, në 2020... (p. 3.2) ... sipërfaqja totale e katit të parë banimi (k. dytë ndërtesës) të objektit 3-katësh është 180m². Nuk është përfunduar kati i parë i banimit për një sipërfaqe 80 m². Kanë përfunduar punimet për një sipërfaqe rreth 100 m², të kryera gjatë vitit 2015 nga unë, përveç karabinasë që ka qenë pjesë e objektit 2 kate ekzistues, ndërtuar nga vëllai im, ***.***, para vitit 2006... (p. 3.3) ... Pjesa mbi katin e tretë (k. dytë banim) është kafazi i shkallëve dhe është përfunduar në vitin 2010 si karabina, sipas lejes së ndërtimit, datë **.7.2008... (p. 4) ... të ardhurat në shtetin anglez nëntor 2000 - maj 2004 kanë qenë rreth 60 mijë paund. Të ardhurat e vëllait, ***.***, në shtetin grek 1992-2001, kanë qenë rreth 16 milionë dhrahmi. (2001-2004 nuk ka qenë në shtetin grek, arsye shëndetësore). 2004 – 2010 është paguar 65 euro dita...”*.

15.5 Në procesverbalin e datës **.9.2016, mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar: *“Objekti është ndërtuar së bashku me vëllain, më tepër kontribute ka vëllai nga emigracioni 1995-2001. Pjesa takuese 50%. Vlera është investuar nga vëllai. Është në proces legalizimi në emrin tim një pjesë e godinës, e cila është ndarë pothuajse në mes, duke u bazuar në ndarjen e tokës prej 1.000 m² në dy pjesë të barabarta. Vlera e investuar nuk është deklaruar për pamundësi llogaritje, pasi është ndërtuar nga vëllai, nuk është nxjerrë leja e shfrytëzimit dhe nuk është kryer akti i kolaudimit. Do të paraqes dokumente të vëllait, pasi unë kam qenë pa dokumente... Kati papafingo nuk është ndërtuar... Aktualisht banoj në katin e dytë, kati parë është i papabanuar, ndërsa në katin e tretë banon dhëndri im, pa detyrim për momentin...”*.

15.6 Në vlerësim të akteve të administruara, lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë godinë banimi 3 kat +1 kat papafingo, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën

“Vetting” dhe deklaratën para fillimit të detyrës (dorëzuar në nëntor 2015), ka deklaruar: “*Të ardhurat për ndërtimin e këtij objekti janë siguruar nga emigracioni nga unë, deklaruesi, në shtetin anglez, gjatë viteve 2000-2004*”, për të cilat subjekti nuk deklaron as vlerën përkatëse apo dokumentacion provues. Mungesa e dokumenteve provuese pranohet edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratimet e dhëna në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së të datës **.9.2016, në të cilën deklaron se nuk ka dokumentacion provues lidhur me periudhën e qëndrimit në Angli, duke paraqitur si rrethanë vetëdeklarimin e bërë prej tij në: “*Formularin e Dekriminalizimit*”, në të cilin deklaron se, *prej tetorit 2000 deri në qershor 2004, ka qëndruar në adresën nr. **, *** ***, ***, ***, UK.*

15.7 Vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. 8, subjekti deklaron më tepër rreth të ardhurave të fituara nga emigracioni, mënyrën e administrimit të tyre, si dhe sjelljen e tyre në Shqipëri, duke specifikuar se: “*... këto të ardhura, përveç atyre që kam shpenzuar për nevojat e mia personale, i kam dërguar në Shqipëri pjesë - pjesë, sipas rastit, nëpërmjet shokëve të mi, që ishin me dokumente të rregullta, gjatë viteve 2001-2004, dhe ia kanë dorëzuar sipas traditës shqiptare familjes sime, konkretisht nënës time, ***,***... Nëna ime ka luajtur rolin e kryefamiljares dhe një pjesë i kanë shpenzuar për nevojat e familjes. Në vitin 2008, kur unë mora lejen e ndërtimit për të ndërtuar shtëpinë, nëna ime më dha një pjesë të këtyre parave që i kishte ruajtur vetë, për të ndërtuar shtëpinë. Pra, unë, subjekti, nuk i kam deklaruar këto para në deklaratën e vitit 2005, sepse i kishte nëna në administrim dhe posedim si kryefamiljare. Unë kam deklaruar në vitin 2005 vetëm gjendjen time personale dhe jo të nënës dhe familjarëve të tjerë. Në këtë mënyrë e kam kuptuar mënyrën e deklaramit në atë kohë, pa pasur asnjë qëllim dhe arsye për të mos i deklaruar”.*

15.8 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të provuar të kundërtën, lidhur me:

- Pasuritë *truall*, pasi duket se subjekti nuk arrin të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive me prova, duke rezultuar në pamundësi financiare në vlerën – 400.000 lekë dhe duket se subjekti i ka blerë pasuritë tokë “arë” me çmim të ulët;
- Për pasurinë *godinë banimi 3+1 kate*, pasi subjekti nuk arrin të provojë me dokumentacion të ardhurat e ligjshme të deklaruara se kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë⁸;
- *Ka paqartësi në deklaratimet e subjektit në lidhje me kohën e investimit në objektin godinë 3 kate e kombinuar;*
- *Subjekti nuk ka deklaruar gjendje cash në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2005;*
- *Subjekti ka pasur pamjaftueshmëri financiare në vlerën totale të investimit të kryer prej tij prej 7.514.635⁹ lekësh, pasi nuk arriti të provojë të ardhurat nga emigracioni, të cilat i ka deklaruar si burim për këtë ndërtim.*

⁸ Komisioni ka hartuar analizën financiare për periudhën 1.7.2005 deri në 31.10.2015, duke mos përfshirë në koston/investimin e ndërtimit të godinës të kombinuar 3 kate, të ardhurat familjare të subjektit nga pagat për vitet 2005 – 2015, pasi subjekti gjatë gjithë deklaramëve të veta ka shpjeguar se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga emigracioni i tij në shtetin anglez.

⁹ Vlera e përlogaritur nga Komisioni, bazuar në metodologji të detajuar, referuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit.

15.9 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar:

15.9.1 Lidhur me depozitën pranë *** Bank, në vitin 2007, e cila është deklaruar nga subjekti se ka shërbyer si burim për blerjen e pasurive tokë-arë, subjekti ka pretenduar se burimi i të ardhurave janë nga emigracioni në shtetin anglez prej muajit nëntor 2000 deri në muajin qershor 2004¹⁰. Ndërsa për sa i përket konstatimit mbi blerjen e pasurisë tokë-arë me çmim më të ulët sesa çmimi i tregut në vitin 2007, subjekti ka prapësuar se për këtë sipërfaqe toke prej 1.000 m² babai, i ndjeri ***.***, ka bërë një marrëveshje verbale me shitësin dhe familjarët e tij që në vitin 1998¹¹, duke rënë dakord për çmimin e blerjes së tokës “arë” prej 1.000 m² (ndarë në dy parcela 724 m² dhe 276 m²), në vlerën 400.000 lekë, pavarësisht se kontrata e shitjes dhe çmimi i blerjes janë konkretizuar në vitin 2007.

15.9.2 Në përfundim lidhur me pasuritë *truall*, subjekti ka pretenduar se është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurisë (blerjes së pasurisë tokë “arë”, në vlerë 400.000 lekë, për pjesën takuese ½ e shumës 400.000 lekë), me të ardhura nga emigracioni në shtetin anglez, gjatë viteve 2000-2004, në referencë të nenit 32, pika 2 të ligjit nr. 84/2016.

15.9.3 Në lidhje me pasurinë *godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo*, subjekti ka prapësuar se burimi i të ardhurave është nga punësimi si emigrant në shtetin anglez, duke vënë në dispozicion të hetimit administrativ një analizë mbi kostot e ndërtimit, sipas të cilës pretendon se nga vlera 6.918.105 lekë, llogaritur në situacionin e datës **.9.2016 (me TVSH), vetëm vlera prej 3.576.580 lekë është pjesa takuese që i përket ndërtimit të bërë nga vetë subjekti, ndërsa diferenca është kosto që i takon ndërtimit të bërë nga ***.***, për katin e tretë, në të cilin ky i fundit banon. Subjekti, në prapësimet e tij, ka ritheksuar faktin se kjo pasuri është një pasuri e krijuar përpara fillimit të detyrës, duke pretenduar përsëri se në lidhje me të ardhurat nga emigracioni në shtetin anglez, në vitet 2000-2004, gjendet në kushtet e pamundësisë objektive, referuar nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016.

15.10 Komisioni, pasi ka vlerësuar pretendimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, në përfundim, ndër të tjera, ka arritur në konkluzionin se: “... Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues vlerësoi se: (i) Subjekti e ka deklaruar saktë këtë pasuri si në deklaratat periodike dhe në atë Vetting; (ii) Kjo pasuri është një pasuri e krijuar shumë vite para detyrës së tij si prokuror dhe subjekt i ligjit nr. 84/2016; (iii) Duke qenë se burimi i krijimit të kësaj pasurie janë të ardhurat nga emigracioni i subjektit në Angli, të cilat janë edhe burim krijimi të pasurisë nr. 2¹², analiza e tyre është trajtuar në pasurinë nr. 2; (iv) Çmimi i blerjes së kësaj pasurie vlerësohet si shprehje e lirisë kontraktuale të palëve në një marrëdhënie juridike civile... ”.

15.10.1 Për pasurinë *godinë e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo*, Komisioni, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar: “... Lidhur me përlllogaritjen e vlerës së investimit të kryer, Komisioni u është referuar sipërfaqeve që rezultuan nga praktika e ALUIZNI-t, përcjellë nga subjekti për legalizim, si dhe referencave në çmimet e EKB-së. Rezultoi e provuar se

¹⁰ Për më tepër referohuni shpjegimeve të detajuara të subjektit në aktin “Parashtrime mbi rezultatet e hetimit administrativ”.

¹¹ Komisioneri Publik sjell në vëmendje se ndërtimi i godinës, sipas deklaramit të vetë subjektit mbi këtë sipërfaqe toke, ka nisur prej vitit 1996.

¹² Komisioni i referohet në këtë rast pasurisë *godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo*.

ndërtimi i këtij objekti ka nisur në vitin 1996 (nga vëllai i subjektit, z. ***,***), dhe është në gjendjen aktuale që prej vitit 2015. Pra, nuk ka prova që të provojnë kryerjen e këtij investimi pas fillimit të detyrës si prokuror. Nga hetimi rezultoi e provuar se deklarimi që subjekti ka bërë për burimin e krijimit të kësaj pasurie ka qenë koherent, të ardhurat nga emigracioni në Angli. Gjithashtu, rezultoi e provuar se subjekti ka qenë në emigracion dhe këtë fakt e ka deklaruar edhe si detyrim të ligjit për dekriminalizimin. Është gjithashtu e provuar se subjekti nuk ka paraqitur prova që të vërtetojnë se këto të ardhura të deklaruara janë të ligjshme në kuptim të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Ai ka bërë përpjekje për të siguruar dokumentacion që vërteton transfertat e shumave monetare nga Anglia në Shqipëri, gjatë kohës kur ishte emigrant, shuma të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë në fjalë, por nuk ka mundur t'i sigurojë ato... Komisioni vlerëson në lidhje me pasurinë e subjektit të rivlerësimit në një optikë të përgjithshme, sipas standardit kushtetues të parashikuar në nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës të “shpjegimit bindshëm” të pasurisë, duke zbatuar parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, në kuptim të parashikimit të nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, i cili obligon organet e rivlerësimit që, në mënyrë diskrecionale, por të arsyetuar e të shpjeguar, të shqyrtojnë procesin e rivlerësimit të një subjekti, duke konsideruar zbatimin e këtyre parimeve të së drejtës administrative të aplikueshme¹³. Në përfundim, për sa më sipër, Komisioni çmon se mungesa e burimeve të ligjshme që rezultojnë nga analiza financiare e kryer, duke mos përfshirë në të të ardhurat nga emigracioni, nuk duhet të konsiderohet si një rrethanë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016”.

16. Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së të datës 30.5.2023, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni lidhur me vlerësimin e situatës financiare, mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimeve që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë *godinë e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo*¹⁴, duke analizuar si më poshtë:

16.1 *Së pari*, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor duke referuar vlera të ndryshme për investimin e kryer në deklaratimet e tij në D-Vett., deklaratën e vitit 2004, deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015 dhe përgjigjet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ, lidhur me vlerën/kostot e ndërtimit të pasurisë *godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo*. Deklarimet e subjektit mbi ndërtimin e një pjesë të pasurisë nga shtetasi ***,***, dhe mbulimin e kostove nga ky i fundit, duken kontradiktore, pasi në deklaratën e vitit 2015 (para fillimit të detyrës), subjekti nuk rezultoi të ketë deklaruar posedim apo investim nga ky shtetas, përkundër deklaratimit të tij në D-Vetting dhe deklarimeve gjatë hetimit administrativ. Deklarime kontradiktore konstatohen edhe lidhur me vlerën e ndërtimit dhe burimet e

¹³ Për më tepër, referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 23-24 të vendimit.

¹⁴ Nga aktet e administruara në dosje, si nga korrespondenca e Komisionit dhe ato të paraqitura nga subjekti z. Buci, në konsideratë të konstatimit se pasuria *godinë e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo*, nuk ka pësuar ndryshime pas vitit 2015, rezultojnë këto të dhëna: (1) pasuria me numër ***/***/***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 180 m², pronari subjekti i rivlerësimit z. Buci, pjesa takuese 1/1; (2) pasuria me numër ***/***/***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 132 m², pronari subjekti i rivlerësimit z. Buci, pjesa takuese 1/1; (3) pasuria me numër ***/***/***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 170 m², pronari subjekti i rivlerësimit z. Buci, pjesa takuese 1/2; (4) pasuria me numër ***/***/***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 111 m², pronari, subjekti i rivlerësimit z. Buci, pjesa takuese 1/2.

përdorura. Kështu në DV-2004, subjekti ka deklaruar vlerë ndërtimi prej 10.000.000 lekë¹⁵, me burim të ardhura të vëllait nga emigracioni. Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015, subjekti nuk deklaron vlerë të pasurisë, deklaron pjesë takuese 100%, ndërsa si burim deklaron të ardhurat e tij nga emigracioni gjatë viteve 2000-2004, pa përcaktuar shumën e këtyre të ardhurave. Në D-Vett., subjekti deklaron vlerën e ndërtimit prej 6.918.2015 lekë, pjesë takuese 100%, dhe burim të ardhura nga emigracioni gjatë viteve 2000-2004 (pa deklaruar përsëri shumën e këtyre të ardhurave të realizuara), ndërkohë në prapësime gjatë hetimit administrativ, subjekti pretendon se është investuar prej tij vetëm vlera prej 3.576.580 lekë¹⁶. Në këto kushte, deklaratimet kontradiktore të mësipërme lidhur me vlerën e investuar për pasurinë dhe burimet e përdorura për krijimin e saj, çojnë në pamundësi të kontrollit dhe verifikimit të saktë të burimit, kohës dhe vlerës së krijimit të kësaj pasurie.

16.2 *Së dyti*, për sa i përket ligjshmërisë së burimeve të përdorura për investimin në godinën e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo, të analizuar në të gjitha variantet e deklaruara nga ana e subjektit, rezulton se ky i fundit nuk arrin të provojë ligjshmërinë e burimeve të pretenduara si të ardhura nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar. Aktet e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, fotografi dhe deklarimi i tij në formularin e dekriminalizimit, dorëzuar pranë organeve përgjegjëse, nuk provojnë as masën e të ardhurave të krijuara dhe as ligjshmërinë e tyre, sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe jurisprudencës së Kolegjit. Komisioneri Publik sjell në vëmendje këtu dhe mosdeklarimin nga ana e subjektit të posedimit të kursimeve në “likuiditete cash”, në deklarimin e parë pranë ILDKPKI-së, në vitin 2005, në pozicionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore.

16.3 *Së treti*, nisur nga sa më sipër, sikundër kemi mbajtur qëndrim edhe në raste të tjera, çmujmë se në rastin konkret, referenca dhe arsyetimi i Komisionit bazuar në parimin e “proporcionalitetit” apo atë të “objektivitetit”, për të mos aplikuar nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016, është i gabuar dhe jo plotësisht i justifikuar në normativën kushtetuese dhe atë ligjore. Parimi i proporcionalitetit, si një nga parimet “klasike”, që ka gjetur vlerësim të vazhdueshëm në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, është trajtuar gjerësisht lidhur me të drejtat e njeriut, mbrojtja e të cilave përbëjnë bazën në një shoqëri demokratike. Ky parim kuptohet më mirë nga pyetja vendimtare, se sa, dhe si kufizohet “thelbi” (i së drejtës), dhe se si mjetet përcaktuese ndërveprojnë me elementet e tjera të qenësishme në vlerësimin e tij¹⁷. Pra, një kufizim do të cenonte “thelbin”, duke cenuar kështu edhe parimin e objektivitetit, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjetit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet.

16.3.1 Në këtë kontekst, nuk duhet të përjashtojmë natyrën e procesit të rivlerësimit, kushtetutshmërinë e tij në respektimin e parimeve mbrojtëse e garantuese për subjektet që i

¹⁵ Për këtë vlerë të deklaruar, subjekti pretendon se janë deklaruar në “lekë të vjetra”. Sikundër konstatohet edhe në Rekomandimin e ONM-së, duket se ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar “në lekë të reja” blerjen e automjetit në shumën 600.000 lekë dhe të ardhurat nga paga 46.000 lekë.

¹⁶ Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në parashtrime se pjesa tjetër e investimit është kryer nga shtetasi ***.***, për katin II, në vlerën 2.191.960 lekë, pa TVSH. Duket se ky pretendim bie ndesh me deklarimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e ILDKPKI-së, ku ka deklaruar se “... në katin e dytë banon dhëndri im, pa detyrim për momentin...”.

¹⁷ Shihni ndër të tjera: GJEDNJ, “Tinnelly & Sons Ltd dhe të tjerët dhe McElduff dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar”, 10 korrik 1998.

nënshtrohen, duke sjellë në vëmendje këtu vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese¹⁸. Sipas nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se Komisioni dhe Kolegji ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

16.3.2 Nga leximi i kësaj dispozite, në vështrim sa parashtruar dhe më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se qëllimi i parashikimit të parimeve që udhëheqin veprimtarinë e dy institucioneve rivlerësuese, pra Komisioni dhe Kolegji, është në funksion të garantimit të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, dhe parimi i proporcionalitetit në këtë rast nuk mund të merret i shkëputur e të gjejë zbatim rast pas rasti, në raport me shkallën apo zbatimin e masës disiplinore, që gjen zbatim si rezultat i procesit të rivlerësimit dhe qëllimit të ndjekur nga neni 179/b, pika 1, të Kushtetutës. Rëndësinë e këtij procesi dhe qëllimit të tij në raport me të drejtat e subjektit, e reflekton më së miri neni A i aneksit të Kushtetutës, dispozitë e cila ka përcaktuar kufizimin pjesërisht të respektimit të disa të drejtave sipas nenit 17 të Kushtetutës.

16.3.3 Sa më sipër është vetë Kushtetuta dhe ligji, të cilat kanë parashikuar si garancitë e nevojshme ndaj subjekteve që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit¹⁹, ashtu dhe kufizimet përkatëse. Si rrjedhojë, masat e marra nga organet e rivlerësimit gjatë veprimtarisë së këtij juridiksioni të posaçëm, e për më tepër në rastet kur konstatohen jo vetëm një, por disa problematika domethënëse, parimi i proporcionalitetit nuk mund të shërbejë për anashkalimin e vetë qëllimit për të cilin është ngritur procesi i rivlerësimit dhe zbatimit korrekt të ligjit të posaçëm.

16.4 Duke përfunduar, pamjaftueshmëria e konsiderueshme financiare e konstatuar nga mungesa e burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë *godinë e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo*, në vlerën 7.514.635 lekë²⁰, pasaktësitë dhe deklaratimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, së bashku me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar nga Komisioni për mbulimin e shpenzimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të për vitin 2016, në shumën – 464.014 lekë²¹, të çojnë në situatën ligjore që subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklaratimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

16.5 Komisioneri Publik konstaton, gjithashtu, se përfundimi tjetër i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit e ka krijuar pasurinë përpara marrjes së detyrës, bie në kundërshtim me jurisprudencën e qëndrueshme të Kolegjit, referuar vendimeve (JR) nr. 2/2019, nr. 31/2019, nr. 12/2020, nr. 13/2020 dhe nr. 3/2021. Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit, në këtë rast, duke referuar vendimin e Kolegjit (JR) nr. 6/2022, është jo relevant me situatën faktike dhe

¹⁸ [“67. Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së]... [Për rrjedhojë, për shkak të garancive që ofrojnë këto organe, vlerësohet se subjekteve të rivlerësimit u garantohet e drejta e ankimit në një shkallë më të lartë gjykimi, sipas nenit 43 të Kushtetutës, e cila ka të drejtë të gjykojë në themel çështjen dhe të vendosë përfundimisht në lidhje me të”].

¹⁹ Shihni edhe opinionin CDL-AD (2016) 036 të Komisionit të Venecias.

²⁰ Referohuni vendimit të Komisionit në f. 22, prg. 2.20.7.

²¹ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 33-34, të vendimit.

rrethanat objektive të rastit objekt ankimi, e për këtë arsye, ky vendim nuk mund të merret në konsideratë për subjektin e rivlerësimit, z. Buci.

IV.B Gjetje të tjera, marrëdhënia kontraktuale e qirasë e subjektit me Bashkinë Kamëz

17. Nga hetimi administrativ²² ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e qiradhënësit, ka nënshkruar kontratën e qirasë me nr. *** prot., datë **.9.2022, me palën qiramarrëse, Bashkinë Kamëz, me objekt kontrate, dhënie me qira të katit përdhe me sip. 132,48 m² dhe sip. prej 60 m² oborr, të godinës së kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo, me qëllim përdorimi për nevojat e Bashkisë Kamëz.

17.1 Komisioni e ka vlerësuar këtë marrëdhënie qiraje mbi bazat e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, duke konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit. Për këtë arsye, subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën.

17.2 Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka prapësuar se kontrata e qirasë e lidhur me Bashkinë Kamëz nuk është një akt administrativ apo kontratë administrative, por është një kontratë civile, që është lidhur sipas dispozitave të Kodit Civil. Subjekti ka shpjeguar më tej, se nuk mund të jetë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi e ushtron funksionin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër.

17.3 Komisioni, pasi ka vlerësuar të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, duke e konsideruar kontratën të natyrës administrative, në përfundim, e ka analizuar situatën faktike si përjashtim të lejuar nga vetë ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar, duke iu referuar nenit 21, pika 4, të këtij ligji, i cili përcakton se nga ndalimet e pikave 1, 2 dhe 3, përjashtohen rastet kur lidhja e kontratës ... “c) bazohet në ligje të veçanta, për qëllime publike ose për trajtime të posaçme të kategorive të ndryshme të zyrtarëve”. Për të përcaktuar nëse kontrata e qirasë në këtë rast është lidhur për qëllime publike, që përjashtohet nga ndalimet e pikës 4/1, të nenit 21 të këtij ligji, Komisioni ka marrë për referencë edhe ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore, nenin 23 të tij²³. Në përfundim, Komisioni ka arritur në konkluzionin se: [...] kontrata e lidhur midis subjektit dhe Bashkisë Kamëz, me të cilën kjo bashki ka marrë me qira ambientin në pronësi të subjektit, për ta përdorur si kopsht për fëmijë, është kontratë e lidhur për qëllime publike dhe, si e tillë, bën pjesë në rastet që përjashtohen nga ndalimi i pikës 1, të nenit 4 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, që do ta vendoste subjektin në situatën e konfliktit të interesit [...]²⁴.

18. Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së të datës 30.5.2023, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi çmon se përfundimi i arritur prej tij është rrjedhojë e një interpretimi të zgjeruar të qëllimit të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave dhe ndalimeve të parashikuara në të, parë kjo

²² Referuar akteve të vëna në dispozicion nga Bashkia Kamëz, me shkresën nr. ***/** prot., datë **.3.2021.

²³ Bashkia në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, ka ndër të tjera, funksion të saj: “... Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe”.

²⁴ Për më tepër, referohuni në f. 29 – 30, të vendimit të Komisionit.

edhe në raport me etikën profesionale, si mundësi apo shkak për cenimin e figurës së magjistratit.

18.1 *Komisioneri Publik*, referuar arsytimit të Komisionit, konstaton se ky i fundit ka arritur në përfundimin se: (i) kontrata e qirasë është e natyrës publike dhe (ii) është lidhur për një qëllim publik nga organi administrativ në ushtrim të funksioneve të tij sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore, e në këto kushte, ka interpretuar përjashtimin e parashikuar nga neni 21, “*Ndalimi i lidhjes së kontratave*”, pika 4, germa “c”. Duket se ky interpretim është i zgjeruar, duke iu larguar qëllimit dhe frymës së vetë ligjit dhe dispozitës së referuar. Në interpretim literal të pikës 1, të nenit 23, të ligjit nr. 9367/2005, i ndryshuar, konstatojmë se ajo paraqitet si një rezervë absolute e natyrës ndaluese, parashikuar nga ligjvënësi me ndryshimet që ka pësuar ky ligj pas prillit të vitit 2014. Kjo normë, në mënyrë të qartë përcakton se: “**Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e *prokurorët* në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik**”. Thënë më thjeshtë, asnjë prokuror në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, nuk mund të lidhë kontratë me anjë institucion publik.

18.2 Qëllimi i kësaj dispozite, për efekt edhe të procesit të rivlerësimit, duhet kuptuar se magjistrati, për shkak funksioni, është i kufizuar dhe e ka të ndaluar të hyjë në ato marrëdhënie juridike, nga të cilat përfiton të mira nga kontratat publike. Megjithatë, edhe në këtë rast, ligjvënësi ka parashikuar disa përjashtime specifike, listuar në rend zbritës në pikën 4, të nenit 21 të ligjit. Në analizë të këtyre rasteve, specifikisht, germës “c”, vlerësojmë se ajo duhet interpretuar brenda frymës dhe qëllimit të normës, që ndryshe nga përfundimi i Komisionit, çmojmë se është kufizimi i magjistratit për të përfituar të mira nga kontratat publike. Ky përfundim përforcohet nisur nga natyra e këtyre kontratave dhe shtrirjes/përdorimit që ato kanë në qarkullimin civil. Në vlerësim të karakteristikave dalluese të kontratës publike, të cilat përfshijnë në mënyrë kumulative ose alternative shumë elemente, veçojmë: *raportet e pabarazisë mes palëve, kryerjen e një misioni shërbimi publik, ushtrimin e prerogativave të fuqisë* (pushtetit) publik, si dhe *përmbushjen e interesit publik*. Këto elemente, që karakterizojnë të drejtën publike, kanë për qëllim përmbushjen e misionit thelbësor të administratës publike, që është misioni i interesit publik²⁵.

18.3 Mbi këtë bazë, duke mbajtur në konsideratë *ratio*-n (qëllimin), e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, përkufizimeve të përcaktuara nga ky ligj për “konfliktin në dukje të interesit²⁶” apo “konfliktit të mundshëm të interesit²⁷”, duket se interpretimi dhe arsytimi i Komisionit që subjekti përjashtohet në këtë rast nga ndalimi i

²⁵ Për më tepër, shihni vendimin nr. 00-2021-1264, datë 12.7.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

²⁶ Sipas nenit 3, pika 4, germa “b”, me konflikt në dukje të interesit kuptohet: “gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë apo mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë”.

²⁷ Ndërsa me “konflikt të mundshëm interesi, kuptohet: “gjendja, në të cilën, interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë, në të ardhmen, shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara”.

parashikuar ligjor, pasi ka lidhur një kontratë publike dhe për një qëllim publik, nuk gjendet i bazuar. Të gjitha kontratat e lidhura me institucionet publike, të cilat paraqesin karakteristikat dalluese të përshkruara më sipër, janë të natyrës publike dhe ndjekin qëllimin për përmbushjen e një interesi publik. Në këtë kontekst të analizuar, Komisioneri Publik, ndryshe nga Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit dhe ndalimit për të përfituar të mira, fonde publike nga kontratat publike, rrethanë, e cila duhet të merret për bazë në vlerësimin tërësor të rastit.

V. Kërkimi i ankimit

19. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenin 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

20. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

21. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 651, datë 27.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit, zotit Urim Buci.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO

I bashkëlidhet këtij ankimi:

- Rekomandimi për ushtrim ankimi i një Komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së, nr. 314/1 prot., datë 30.5.2023.



International Monitoring Operation
*Project for the Support to the Process of Temporary
Re-evaluation of Judges and Prosecutors in Albania*



Prot. No. 314/1

Tirana, 30/05 2023

To the

Public Commissioners

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 6

Tirana

Albania

Case Number **DC-P-DIB-1-03**

Assessee **Urim BUCI**

RECOMMENDATION TO FILE AN APPEAL

According to

Article B, par. 3, point c of the Constitution of the Republic of Albania (hereinafter “Constitution”), Annex “Transitional Qualification Assessment”, and Article 65, par. 2 of Law No. 84/2016 “On the transitional re-evaluation of judges and prosecutors in the Republic of Albania” (hereinafter “Vetting Law”).

1. Introduction

Mr. Urim BUCI has been assessed by the Independent Qualification Commission (hereinafter "IQC") pursuant to Article 179/b, par. 3 of the Constitution and in accordance with the provisions of the Vetting Law. The IQC decided to confirm the assessee in duty.

The International Observers (further: IOs or IMO) recommend the Public Commissioners to file an appeal against the whole results of the assets assessment.

IMO's views are that the evaluation of evidence, the reasoning and the jurisprudence quoted by the IQC in its support are not correct and, as a result, a different outcome should have been reached by the panel that would have led to the dismissal of the assessee.

2. Grounds of the recommendation and their analysis

For the assets assessment

IMO challenges the conclusions of the panel in regard to the whole assets assessment and, in particular, those related to the original financial inability of 7,514,635 ALL to build the dwelling with the migration income.

The reasoning outlined in the IQC decision in the assets assessment are wrong and incorrect, above all those outlined in paragraphs from 2.19 onwards of the decision, which stated that:

"2.19 The assessee had a financial inability of 7,514,635 ALL to build the dwelling with the migration income.

[...]

2.23 It was proven that the construction of this dwelling started in 1996 (by the assessee's brother, Mr. *** ***) , and it is in the current situation/state since 2015. Thus, there is no evidence to prove the delivery of this investment after assuming office as prosecutor.

2.24 The Commission holds that such situation puts the panel in a difficulty to prove the genuineness of his statements and the lawful sources of the incomes used to create the asset described above, which appears to have been created from 1996 - when he was still a student - to 2015, the time when he was appointed as prosecutor

2.25. The Commission holds that regarding the assets of the assessee, in a general optic and based on the constitutional standard stipulated in Article D, paragraph 3 of the Annex to the Constitution, the explanations of the assessee on the asset are convincing. The Commission in that regard applies the principles of objectivity and proportionality in the meaning of Article 52, paragraph 1, of the Law no. 84/2016, which obligates the re-evaluation bodies to discreetly, but reasonably and explanatorily, review the re-evaluation process of an assessee by considering the implementation of these principles of the applicable administrative law.

[...]

2.27. In addition to the above reasoning, the Commission considered several circumstances integrally and in harmony with each other, such as his statements on being in migration in the de-criminalisation declaration, the coherent declaration in the 2005 PAD and the one before assuming office in terms of the source of incomes of this asset, the fact that this is an asset that was created before he would assume office as prosecutor, and the fact that there is no data to suggest that he created assets or liquidities after assuming such office.

[...]

2.29. In the meaning of the above-mentioned provision, the Commission holds that the inability to prove migration incomes, in light of the circumstances objectively analysed above, even though according to the evaluation of the adjudication panel the assessee is not considered to be in the situation of Article 32, paragraph 2, of the Law no. 84/2016, given that all of the requirements of this provision are not cumulatively proven.

2.30. The absence of any data casts doubts that the assessee - by declaring such incomes - aimed to defraud the re-evaluation bodies, or even intentionally made a different false declaration. Notwithstanding, the adjudication panel holds it to be unfair considering such factual situation as a shortcoming of deficiency that triggers consequences for the

assessee in terms of applying the measure of dismissal from office. Moreover, the asset would appear having been created before the assessee was appointed as prosecutor. Given that this shortcoming is the only one identified in relation to the asset evaluation criterion of the assessee, and placed in the above-mentioned context, it according to the adjudication panel is not deemed proportional to trigger the application of the measure of dismissal from office, as a necessity to achieve the objective stipulated in the law – i.e. reinstating the “public’s trust in the justice system.”

To support this conclusion, the IQC decision quoted an excerpt from AC Decision no. 6 dated 19.03.2022 related to the appeal decided in the case of *** ***, and the IQC decision affirms that:

“2.31. This stance of the adjudication panel is in compliance with Decision no. 6, of 19.03.2022, which reasons, among other, that: *‘The situation described above places the assessee and the re-evaluation bodies in the situation of an inability to check the genuineness of his declarations and of the lawful sources of the incomes [used] to create the asset that was described above, which appears to have been created in the years The negative result defined in the Commission’s decision regarding this period, but also according to the analysis made in the Appeal Chamber, ..., is a consequence of the non-inclusion of the income generated in the years ... - ... The Chamber will reason for the importance and the impact that this circumstance will have on the asset assessment criterion, considering all the cases for which the Commission has concluded with its decision-making... The Chamber takes into consideration the fact that, although the evidence available from state institutions does not confirm the legitimacy of the income claimed by the assessee, ... in the absence of any indication that makes you suspect that the assessee, by declaring such income, intended to deceive the vetting bodies or has deliberately stated otherwise in a false way, assesses that this factual situation is not deemed to be right to be considered as a deficiency or shortcoming which would lead to the consequence of the imposition of the measure of assessee’s dismissal from duty. This shortcoming remains the only one found in relation to the asset assessment criterion for the assessee and when put in the above context, it is not considered that it can proportionally produce the imposition of the measure of dismissal from office, as a necessary measure to achieve the goal defined in the law for restoring public confidence*

in the justice system. ... In this assessment, the Chamber also takes into consideration the fact that the property turns out to have been created and existed before the assessee was appointed to the position of prosecutor.'

2.32. In conclusion, on the foregoing, The Commission deems that the lack of lawful sources resulting from the financial analysis carried out, not including income from immigration, should not be considered as a circumstance that places the assessee in the conditions of an insufficient declaration according to the provision of the article 61, paragraph 3 of the law no. 84/2016 [...].

First and foremost, IMO needs to point out that the case of *** *** (which AC decision 6/2022 refers to) and the current one cannot be considered identical and cannot be compared.

The case of *** *** , indeed, was characterized by the existence of some evidence that could be properly assessed by the vetting bodies to ascertain the existence of an income, such as evidence related to the existence of the practice of the activity as a lawyer (along with the payment of his relevant health and social contributions) in the years 1994-1998. What was at stake, in that case, was the exact proof of the amount of lawful income claimed by the assessee which remained unproven. In that case the tax authorities were unable to give information on the income during the relevant period. Moreover, some additional circumstances – like the uncertainty of the legal framework - were considered by the Special Appeal Chamber to argue along the line of the application of the principle of proportionality - due to the peculiarities of that case - to not issue the administrative sanction of dismissal.¹

The situation related to the assessee Urim Buci is completely different. IMO opines that the IQC panel drew their conclusions in absence of whatsoever reliable piece of evidence from which it could be inferred the existence of a lawful income as claimed by the assessee, thus going against the basic principle on the assessment of evidence which should be at the basis of the IQC decision and that are established by Art. 81 of the Administrative Procedure Code.²

¹ For more information, please refer to paras. 15.6 through 15.9 of AC Decision 6/2022.

² Please refer to AC Decision 9/20, par. 8.7, where it is stated that:
“8.7 [...] The fact that the Commission did not maintain the same stance as that claimed by the assessee regarding the probative value of the acts administered in the course of the investigation cannot be understood to be a denial of the right to be heard and bring evidence, but as an exercise of the Commission’s attributes to analyse and assess the

IMO is of the opinion that in the case of Urim Buci the assessment of the available evidence, both individually and in its entirety, also in relation to the explanations provided by the assessee to the IQC, must lead to the conclusion that the IQC has not rightfully established the factual situation in accepting the existence of the lawful income claimed by him. Therefore, it is not even possible to talk about the application of the principle of proportionality in a situation where the evidence of the (even sole) existence of an income (let alone lawful) cannot be considered as proved.

Hence, the IQC panel erred in assessing the probative value of certain elements gathered during the investigation and, as a result, there has been an error in assessing the consequence of the probative value of what was gathered regarding legal requirements. The surprising final consequence was that the assessee was considered having reached the required standards to be confirmed under asset assessment aspects, which should not have been the case.³

In IMO's view the current decision does not meet the said legal requirements and the proof of a lawful income as claimed by the assessee can only be considered, in the present case, of a declarative nature,⁴ let alone be incidentally or implicitly ascertained through the application of

issues posed for discussion during the re-evaluation administrative procedure, in line with the principle set forth by Article 81 of the Administrative Procedure Code, as follows: Any public body shall, based on its conviction, deem which facts shall be considered to have been proven based on a detailed evaluation of each piece of evidence separately and all the evidence collectively, and also based on the overall result of the administrative investigation."

³ This interpretation pointed out by IMO is in line with the Vetting Law, which determines the discretion of the Commission "[...] to evaluate based on their internal conviction, any indicia in overall related to the circumstances of the case [...]" (Art. 49(4), 2nd sentence of Vetting Law) and to base their decision "[...] only on documents from known sources, or evidence which is reliable, or is strongly consistent with other evidence [...]" (Art.49(4), 1st sentence of the Vetting Law). It is true that Article 49(4) of the Vetting Law stipulates that: "[...] The Commission or the Appeal Chamber shall not base decisions only on documents from unknown sources, or evidence which is not reliable, lacks credibility or is strongly inconsistent with other evidence. It may be taken into account each indicium as a part of the overall evaluation of evidence [...]" and that Art. 51 of the Vetting Law stipulates that "If the assessee does not present evidence in accordance with article 85 of the Administrative Procedure Code and in case of incomplete evidence, the Commission and the Appeal Chamber may make factual conclusions based on the given evidence, the general assessment of the cases and their internal conviction [...]" But these principles should be considered of a subsidiary nature. As stated in AC 3/2020 in the case of *** ** :

"25.1. Regarding the administration of evidence in procedural terms [...] the Trial Panel draws the attention on the ECtHR case-law in the case Garcia Ruiz v. Spain or Forange S.A. v. France. [...] According to these judgements, the admissibility and assessment of evidence related to merits in general are powers that rest solely with the national courts which must balance the elements collected by them."

⁴ In line with the principles expressed by AC Decision 2/2020 in *** ** , where AC stated that "23.7. Regarding the source of income used for the construction of this house, the Chamber finds that the assessee refers to sources such as family savings and income from work in immigration during 1993 - 1994, which he was not able to prove. Since he did not submit any documents to prove this income, a fact that was confirmed by the

the principle of proportionality which, in the Jurisprudence of the Special Appeal Chamber, has a different purpose and a different meaning.⁵

In addition, the continuous reference of the IQC decision to the fact that some of the assets was created before taking office should be placed in the right perspective to determine its relevance, in line with the AC jurisprudence, amongst other AC decisions no. 2/2019 (on *** ***, paras. 3.1, 3.1.1, 3.1.2 and 3.24), no. 31/2019 (on *** ***, paras. 18 through 21.2), no. 12/2020 (on *** ***, paras. 32 and 33), no. 13/2020 (on *** ***, paras. 34 through 35) and no. 3/2021 (on *** ***, par. 71).

IMO hereby points out that the explanations provided by the assessee during the proceeding were unclear and not linear. Therefore, it must be left to the Public Commissioner to consider whether to request further investigation to the AC. As an example, the periodical annual declaration of 2005 (referred to the year 2004) included the value of 10,000,000 ALL for the 150m2 dwelling built in 1995 and owned in the share of 50% by the assessee. The assessee later explained that the indication of that amount was a material mistake, as expressed in old Leke and not new Leke. The IQC accepted this explanation.

Interesting enough, in the same periodical annual declaration the assessee correctly indicated in new Leke (600,000 ALL) the value of a 1987 vehicle. Even more, the assessee during the administrative investigation had made attempts to justify the original value of the dwelling, almost willing to show a certain availability of funds⁶ whose legal origin and source (if not existence) could be considered more than doubtful.

3. Conclusions

IMO deems that the information and documentation gathered through the administrative investigation grounds the believe that the assessee lacks lawful sources to justify his assets. Hence, the IQC should have reached a different conclusion in consideration of the elements and

assessee during the administrative investigation, all the data on the source of income used for the construction of the house remain of a credible declarative nature, but they cannot create the conviction on their credibility in terms of Article 49, paragraph 4 of Law no.84/2016.”

⁵ See, inter alia, AC decision no. 26/2019 (paras. 46-48) and AC decision no. 25/2021 (par. 18.2).

⁶ See, e.g., paras. 1.8 and 1.10 of the IQC decision.

evidence gathered during it, in line with what has been presented in this Recommendation. The IQC decision is incorrect and inconsistent in arguing on the matter and in accepting the assessee's version which led to his confirmation in office.

Hence, a Recommendation to appeal the IQC decision on the whole assets assessment that confirmed Urim Buci in office is hereby filed, and the Public Commissioner is left with the discretion to include additional grounds to his appeal.

Respectfully submitted,



[Signature]
International Observer

International Observer

International Observer